

VENDIM
Nr. 885, datë 27.12.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 723, DATË 19.11.1998, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7889, DATË
14.12.1994, ‘PËR STATUSIN E INVALIDIT’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 723, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shuma mujore e rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve është 10 000 (dhjetë mijë) lekë.”.

2. Efektet financiare, në masën 16 200 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë, përballohen nga fondi i sigurimeve shoqërore.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama